

**INFORMATORI SHKOLLOR PËR
PROCEDURAT STANDARDE TË VEPRIMIT PËR
MBROJTJE NGA DHUNA NË FAMILJE NË KOSOVË**



Hyrje

Dhunën në familje mund ta definojmë si formë të ushtrimit të autoritetit të një individi ndaj tjetrit, duke shfrytëzuar forma të ndryshme. Dhuna si fenomen shkakton probleme jo vetëm për shoqërinë si tërësi, por edhe për të ardhmen e fëmijëve që vijnë nga familje të dhunshme, sepse ata vuajnë, madje në mënyrë të tërthortë. Secili prej nesh ka të drejtë të jetojë jetën në mënyrë të sigurt dhe sipas nevojave të veta. Dhuna në shtëpi pamundëson sigurinë dhe qetësinë, prek fëmijët, gratë, personat e moshuar dhe anëtarët e tjerë të familjes. Shumë njerëz akoma vuajnë në fshehtësi, në padijeni për të drejtat e tyre dhe ndihmën që mund t'u ofrohet nga institucionet relevante.



Qeveria e Republikës së Kosovës punon me përkushtim në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke konsideruar familjen si qelizë të vetme të shoqërisë në përgjithësi. Në vitet 2011-14, vendi ynë miratoi Strategjinë e parë nacionale për mbrojtje nga dhuna në familje, e cila ka filluar të zbatohet me sukses po në këtë periudhë. Fokus i kësaj Strategjie ishte ngritja e vetëdijes së publikut, përmirësimi i shërbimeve dhe koordinimi mes institucioneve, me çka viktimat do të fitojnë mbrojtje adekuatë kudo në territorin e Republikës së Kosovës.

Duke u nisur nga kjo, përmes një pune të përbashkët dhe përmes përkushtimit të institucioneve shtetërore, sektorit civil dhe institucioneve ndërkombëtare, u shfaq edhe nevoja për hartimin e Procedurave Standarde të Veprimit (PSV). Se barazia gjinore është një prej vlerave thelbësore të një shoqërie demokratike është dëshmuar shumë më herët, prandaj edhe Kosova për ta ndjekur rrugën e integritit evropian bën përpjekje që nëpërmes akteve ligjore dhe nënligjore ta forcojë dhe mbrojë barazinë gjinore. Në suaza të kësaj, me iniciativën e ABGJ janë hartuar PSV duke u bazuar në ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në familje nr. 03/L-182-2010.

PSV për mbrojtje nga dhuna në familje në Kosovë nuk kufizohet vetëm me format e dhunës në familje të përcaktuara me Ligjin për mbrojtje nga dhuna në familje, por përfshin edhe të gjitha veprat penale, të cilat kryhen në kuadër të marrëdhënieve familjare të përcaktuara me Kodin Penal të Republikës së Kosovës

Qëllimi

Qëllimi i këtij informatori është: Informimi, vetëdijesimi dhe edukimi me qëllim të parandalimit të dhunës, me fokus të veçantë në familje dhe dhunën në baza gjinore . Në këtë informator të shkurtër për shkolla, do të paraqesim mekanizmat institucional dhe akterët tjerë të përfshirë drejtpërdrejtë në parandalim, trajtim, mbrojtje dhe riintegrim të viktimave nga dhuna në familje.

Mekanizmat institucional janë:

1. Drejtoritë Komunale për Arsime (DKA) dhe institucionet edukativo- arsimore
2. Policia e Kosovës.
- 3 Mbrojtësi i viktimave/Zyra për Mbrojtjen dhe Ndihmë Viktimave.
4. Prokurori i shtetit.
5. Gjykatat.
6. Qendrat për Punë Sociale.
7. Institucionet shëndetësore: parësor, dytësor, tretësor dhe Qendrat e shëndetit mendor

Akterët mbështetës joqeveritar:

1. Strehimoret dhe
2. Organizatat joqeveritare.

Secili nga këto institucione i ka detyrat dhe përgjegjësitë e veta të përshkruara në PSV dhe të gjitha informatat dhe shërbimet e listuara janë në disponim për viktimat e dhunës pa pagesë 24 orë.

POLICIA E KOSOVËS

Është një ndër institucionet kryesore për mbrojtjen nga dhuna. zakonisht është kontakti i parë për viktimën. Çdo stacion policor ka Njësitë të Hetimeve për Dhunë në Familje. Policia ka për detyrë t'i përgjigjet çdo lloj kërcënimi, akti të dhunës apo shkeljes së urdhrit për mbrojtje dhe këto raste i trajton me urgjencë dhe seriozitet. Policia ka për detyrë ta njoftojë viktimën për të drejtat, ta udhëzojë dhe shoqërojë viktimën, të arrestojë menjëherë të dyshuarit për veprën penale. Policia bën hetimin dhe ndjekjen penale për krimet që kryhen në familje dhe krimet tjera në përputhshmëri me Kodin Penal dhe ligjet tjera të aplikueshme të Kosovës. Policia zbaton urdhrat e mbrojtjes sipas Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, si dhe kanë përgjegjësi të tjera të përcaktuara me ligjet tjera në fuqi.



Mbrojtësi i viktimave/Zyra e kryeprokurorit të shtetit

Mbrojtësit e viktimave janë persona të autorizuar zyrtarë të cilët u ofrojnë mbështetje dhe ndihmë viktimave të krimit për të pasur qasje në organet e drejtësisë, është përfaqësuesi i autorizuar i cili ka kompetencë për: ta njoftuar palën e dëmtuar për të drejtat e tij/saj dhe përfaqësimin e interesave të viktimës në procedurën në prokurori dhe gjykatë; dhe kur është e nevojshme, e referon viktimën tek ofruesit tjerë të shërbimeve, vepron në emër të viktimës kur është e nevojshme dhe e duhur për ta ndaluar shkeljen e të drejtave të viktimës dhe për të kërkuar veprim për garantimin e mbrojtjes së tyre.

- Te drejtat e këtyre viktimave janë:
- E drejta për mbrojtje dhe strehim
- E drejta për trajtim me respekt dhe dinjitet
- E drejta për konfidencialitet
- E drejta për t'u njoftuar me procedurat ligjore
- E drejta për të pranuar kompensim dhe dëmshpërblim

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ju garanton mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Prokurori i shtetit ka përgjegjësi për të shqyrtuar provat e një rasti të dhunës në familje dhe për ta mbështetur ndjekjen penale, kjo përfshin edhe shkeljen e urdhrit mbrojtës. Prokurori ka autoritetin të inicioj procedurë penale sipas detyrës zyrtare (ekspertizës).

Gjykatat i shqyrtojnë me prioritet rastet e dhunës në familje dhe janë të caktuar gjyqtarët e profilizuar për trajtimin e këtyre rasteve. Gjyqtarët kanë përgjegjësinë e trajtimit të palëve dhe individëve që shfaqen para tyre në mënyrë të paanshme, dinjitoze dhe respekt duke siguruar mbrojtje adekuatë për të gjitha palët e përfshira në procedurë.

Qendrat për Punë Sociale

- Qendrat për Punë Sociale (QPS), janë institucione komunale të cilat ofrojnë shërbime sociale dhe familjare për viktimat e dhunës në familje deri në riintegrimin e tyre.
- Secili rast ku përfshihet fëmija, pas pranimit të informatës nga policia e Kosovës apo vet pala, punëtori social intervenon në rast.
- Punëtori social i QPS-së kujdestaron 24 orë, përfshirë vikendet dhe festat dhe asnjë intervistë nuk realizohet me të miturin pa pjesëmarrjen e punëtorit social.
- Roli i punëtorit social është që të ofroj ndihmë, mbrojtje dhe përkrahje për secilin fëmijë në situatë dhune.
- Punëtori social merr vendime edhe për strehim të fëmijës në rastet e dhunës në familje.
- Në raste të caktuara nëse fëmija nuk është vetëm dëshmitar i dhunës në familje por edhe viktimë e drejtpërdrejt, QPS mund të inicioj rastin për marrjen e të drejtës prindërore.
- Gjithashtu, edhe në rastet e dhunës brenda hapësirave të ndryshme, me theks të veçantë në shkollë, në secilin rast kur shteren të gjitha mundësitë nga punëtorët arsimor dhe psikologët e shkollës, QPS intervenon për ndihmë dhe përkrahje.
- QPS, po ashtu, merr pjesë në secilën seancë gjyqësore dhe parim kyç ka mbrojtjen e interesit më të mirë të fëmijës.
- Secili fëmijë ka të drejtën e shprehjes së mendimit të tij dhe dhënien e deklaratës pas moshës 10 vjeçare, duke mos përjashtuar mundësinë edhe para kësaj moshë, nëse vlerëson ekipi profesional.
- Të gjitha informatat në dispozicion të QPS janë konfidenciale dhe nuk publikohen në asnjë rast.

Institucionet shëndetësore

Institucionet shëndetësore, parësore, dytësore, tretësore dhe qendrat e shëndetit mendor, ofrojnë shërbime shëndetësore pa pagesë për rastet e dhunës. Këto institucione identifikojnë, ofrojnë ndihmën mjekësore falas, njoftojnë policinë dhe përgatisin raport me shkrim nëse kërkohet nga organet kompetente.



Strehimoret

Shtëpia e sigurt (Strehimorja) ofron shërbime 24 orë pa pagesë të strehimit për gra dhe fëmijë viktimë/ të mbijetuar të dhunës në familje, të referuara nga institucionet e cekura më lartë si dhe drejtpërdrejtë nga viktimat. Shërbimet e ofruara janë të bazuara në fuqizimin e gruas dhe bazuar në nevojat e saj. Shërbimet që ofrohen në strehimore janë shëndetësore, këshillime psiko-sociale, shëndetësore për shëndetin



riprodhues dhe shëndetin mendor, medikamente, shërbime juridike, informata për legjislacionin, prezente në komunitet për vetëdijesimin e komunitetit për pasojat e dhunës dhe trajnime me institucione relevante të cilat trajtojnë viktimat.

Përveç këtyre për gratë e strehuara ofrojnë kurse profesionale dhe trajnime për rikuperimin nga dhuna në familje, rehabilitimin dhe riintegrimin e saj në shoqëri dhe të gjitha këto shërbime të ofruara janë të licencuara nga institucione relevante.

Përveç këtyre shërbimeve, strehimoret ofrojnë edhe shërbimin për vazhdimin e shkollimit për fëmijët e viktimizuar në sistemin e rregullt arsimor në shkollën më të afërt ekzistuese.

Në Republikën e Kosovës ekzistojnë 7 strehimore të tilla në komunat: Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë, Gjiilan dhe Ferizaj.



Organizatat joqeveritare

OJQ –të punojnë në informim, këshillim dhe parandalim të dhunës dhe janë të familjarizuara me problemin e dhunës.

Institucionet edukativo-arsimore

Veprimet e secilit nga këto institucione të lartcekura ndërlidhen ngushtë me sistemin arsimor. DKA janë përgjegjës për veprimin e edukimit të viktimave të dhunës në familje sipas ligjit në fuqi. Institucionet arsimore janë burime të rëndësishme për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve viktimë të dhunës në familje. Këto institucione kanë një rol të rëndësishëm në ngritjen e ndërgjegjësimit lidhur me dhunën në familje dhe njoftimin e aktereve tjerë kur një fëmijë ka nevojë për mbrojtje.

Institucionet arsimore kanë këto përgjegjësi:

1. Identifikimin e viktimave potenciale
2. Regjistrimin e viktimës në Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsim (SMIA) dhe plotësimin e dokumentacionit në bazë të formularit që është në PSV fq. 24,71, 80 dhe 81 e cila gjendet në uebfaqe të Agjencionit për Barazi Gjinore (ABGJ) me këtë link:

<https://abgi.rks-gov.net/>

3. Informimi i organeve të kujdestarisë QPS ose policisë në rast nevojë.
4. Bashkëpunim me të gjitha organet kompetente për integrim të viktimës në institucionet arsimore në mësimin e rregullt dhe atë joformal sipas rregulloreve në fuqi- UA nr. 01/2014 “Organizimi dhe planifikimi i procesit arsimor në arsimin dhe aftësimin profesional” dhe UA nr. 12/2014 “Përjashtimet në moshë me rastin e regjistrimit në arsimin dhe aftësimin për të rritur”.

INFORMATAT PËR LAJMËRIMET EVENTUALE TË RASTEVE MUND TË BËHEN FALAS NË KËTA NUMRA TELEFONIK:



MINISTRIA E SHËNDETËSISË: 080017777

PROKURORIA: 080011112



**INFORMATAT PËR LAJMËRIMET EVENTUALE TË RASTEVE
MUND TË BËHEN FALAS NË KËTA NUMRA TELEFONIK:**

Policia e Kosovës



Vala
Ipko: **0800 19999**
Fixe-PTK: **038 550 999**
Thirrjet mbeten anonime dhe janë pa pagesë

MINISTRIA E SHËNDETËSISË: 0800 17777

PROKURORIA: 0800 11112